



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Zyra e Auditorit Gjeneral/Kancelarija Glavnog Revizora

AUDITIMI FINANCIAR

KOMUNA E DEÇANIT

PASQYRAT FINANCIARE

PËR VITIN QË PËRFUNDON MË
31 DHJETOR 2007

Prishtinë, Dhjetor 2008

LETËR DORËZIMI

Datë: 26 Dhjetor 2008

Për: Z.Musa Berisha

I nderuar Z. Berisha:

Ky është raporti ynë final mbi rezultatet e auditimit nga Zyra e Auditorit Gjeneral të pasqyrave financiare të Komunës së Deçanit për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2007. Në pajtueshmëri me Rregulloren e UNMIK-ut 2005/33, ky raport do të bëhet publik.

Raporti ynë përmban rekomandimet për veprimet tuaja. Rregullorja 2005/33, Neni 1 B. (e) kërkon që brenda 30 ditëve të publikimit të raportit tonë të auditimit, ju duhet të parashtroni një raport që tregon se si institucioni juaj do të implementoj këto rekomandime. Rapoti juaj pritët më 30 Janar 2009.

E vlersojmë bashkëpunimin dhe mirësjelljen e ofruar stafit tonë gjatë auditimit. Zyra e Auditorit Gjeneral mirëpret bashkëpunimin me ju në të ardhmen në auditimin e pasqyrave financiare të vitit 2008.

Me nderime,

Linda Casella
Auditor Gjeneral

PËRMBAJTJA

I. Përmbledhje e Përgjithshme	5
II. Parathënie	6
III. Statusi i Rekomandimeve të Auditorit nga Vitet e Mëhershme	7
IV. Fushëveprimi i Auditimit	14
V. Mendimi i auditorit	15
VI. Çasja e Auditimit	17
VII. Të Gjeturat Kyqe të Auditimit	19

Shtojcë

- I. Komuna e Deçanit
Pasqyrat Financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2007
- II. Komentet e Menaxhmentit të Komunës

Lista e Shkurtesave dhe Akronimeve

AGJ	Auditori Gjeneral
UA	Udhëzimi Administrativ
OE	Operatori Ekonomik
FNK	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
SNKSP	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
MEF	Ministria për Ekonomi dhe Financa
MSHP	Ministria e Shërbimeve Publike
ZAGJ	Zyra e Auditorit Gjeneral
LPP	Ligji i Prokurimit Publik
SE	Sigurimi i Egzekutimit
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

I. PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Zyra e Auditorit Gjeneral ka kryer auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Deçanit (më tej referuar si “Komuna”) për vitin e përfuduar më 31 Dhjetor 2007.

Për shkak të çështjeve të diskutuara në Pjesën V: Mendimi i auditorit ne nuk ishim në gjendje të japim dhe ne nuk japim një mendim mbi pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2007.

Të gjeturat dhe rekomandimet e ndërlydhura janë paraqitur përbrenda Pjesës VII të raportit. ZAGJ nxit Manaxhmentin e Lartë të Komunës të ndërmarrë veprime korigjuese mbi këto rekomandime dhe para kësaj të paraqesë një Plan Veprimi për shqyrtimin e këtyre rekomandimeve 30 ditë nga pranimi i Raportit Final të Auditimit.

II. PARATHËNIE

Rregullorja e UNMIK-ut 2002/18, datë 4 Tetor 2002, ka themeluar Zyrën e Auditorit Gjeneral (ZAGJ) në Kosovë. Sipas Nenit 3.2 të kësaj rregullore, nga Auditori Gjeneral (AG) kërkohet të kryejë auditim për çdo vit të të gjitha institucioneve të Kosovës që të përcaktojë:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pasqyrë të saktë dhe të drejtë;
- Nëse shënimet financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret e aplikueshme;
- Përshtatshmërinë e kontrolleve të brendshme dhe funksioneve të auditimit të brendshëm;
- Ndërshmërinë dhe drejtësinë e vendimeve administrative të ndërmarra përbrenda institucioneve apo entiteve të audituara; dhe
- Të gjitha çështjet që dalin ga auditimi ose që ndërlihen me të.

Në Mars 2003, Kuvendi i Kosovës ka aprovuar Ligjin Nr. 2003/2 “Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë” që është miratuar zyrtarisht nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) më 12 Maj 2003 me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/17. Neni 42 i Ligjit deklaron se AGJ do të përgatisë dhe t’i dorëzojë Kuvendit dhe PSSP-së një raport mbi deklaratat financiare të organizatave buxhetore për vitin e kaluar fiskal ku do të parashtrihen opinionet e AGJ mbi atë se nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në financat e organizatave buxhetore në fjalë

III. STATUSI I REKOMANDIMEVE TË AUDITORIT NGA VITET E MËHERSHME

Auditimi nga ZAGJ i pasqyrave financiare të Komunës për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2006 ka rezultuar në 56 rekomandime të auditorit, detajet e të cilave janë paraqitur në tabelën më poshtë. Auditimi aktual përcakton se asnjë nga këto rekomandime nuk është zbatuar kënaqshëm.

Nr	E gjetura	Rekomandimi
	Paratë e imëta	
1	Komuna ka bërë shpenzime me para të imëta me qëllim blerjet e vogla, që janë të lejuara nga LMFPD dhe Rregullorja e Instruksionet Financiare Të Thesarit Nr. 2006/02 mbi Shpenzimin e Parasë Publike. Ne kemi përzgjedhur katër monstra për rishikim : nga rishikimi, ne kemi vërejtur se pagesat për, pjesë rezervë të veturave, blerjen e materialit zyrtar, ndarjen e faturave etj, janë bërë. Më poshtë ne shqyrtojmë më detajisht mospajtueshmërinë që e kemi vërejtur.	Menaxhmenti i Komunës nxitet që të përkujdeset që kërkesat e Nenit 9.3 të Rregullës dhe Instruksioneve Financiare të Thesarit Nr. 2006/02 mbi Shpenzimin e Parasë Publike të aplikohen në praktikë.
3	Shmangiet u vërejtën për këto pagesa:Te shitësi Besiana tri fatura në vlerë 265€ në emër të shpenzimeve të reprezentacionit;te shitësi Elita tri fatura në vlerë 119.50€ në emër të furnizimit me inventar;te Kosova press dy fatura në vlerë 195€ në emër të publikimeve;te Kiosku Rilindja tri fatura në vlerë 186€ në emër të shtypit ditor;dy fatura në vlerë 159€ për furnizim me material te shitësi te Ardi;	ZAP rekomandon qe Menaxhmenti I Komunës duhet të përmbahet kërkesave te pikes 9.3 të Rregullës Financiare dhe Udhëzimet e Thesarit për shpenzimet e Parave Publike Nr 2006/02 dhe ato të aplikohen në praktikë
4	Shmangiet u vërejtën për këto pagesa:Te Graniti-RM katër fatura ne vlere 206€ ne emër te furnizimit me inventar;DPT Freskimi dy fatura ne vlerë 135.3€ te Kosova press dy fatura në vlerë 195€ në emër të publikimeve;te Ornica gjashtë fatura ne vlerë 564.5€ në emër të shpenzimeve te reprezentacionit(ushqim dhe pije)	ZAP rekomandon qe Menaxhmenti I Komunës duhet të përmbahet kërkesave te pikes 9.3 të Rregullës Financiare dhe Udhëzimet e Thesarit për shpenzimet e Parave Publike Nr 2006/02 dhe ato të aplikohen në praktikë
5	Shmangiet u vërejtën për këto pagesa: pesë fatura të PTK-së në vlerë 345€ për kredi të telefonit; fatura nr 07/06 dt 08.05.06 ne vlere 95.5€ ne emër te shpenzimeve te reprezentacionit e shitësit Freskimi; fat. nr 32364 dt 19.02.06 në vlerë 57.5 e shitësit Jerina në emër të shpenzime te reprezentacionit;fat pa nr dt 13.03.06 ne vlere 75€ e Eurokom në emër të furnizimit me pjesë rezervë;fat nr 03851 dt 24.2.06 ne vlerë 90 e Ardiani ne emër të furnizimit me goma te përdorura;etj	ZAP rekomandon qe Menaxhmenti I Komunës duhet të përmbahet kërkesave te pikes 9.3 të Rregullës Financiare dhe Udhëzimet e Thesarit për shpenzimet e Parave Publike Nr 2006/02 dhe ato të aplikohen në praktikë
6	Shmangiet u vërejtën për këto pagesa:tri fatura ne vlerë 156€ ne emër te shpenzimeve te mirëmbajtjes –te shitësit Beki;dy fatura te shitësit Rudina ne vlere 149€ ne emër te shpenzimeve te mirëmbajtjes se automjeteve;te(8) fatura te Ornica ne vlere 585€ ne emër te shpenzimeve te reprezentacionit;dy fatura ne vlerë 180€ te Ardiani ne emër të shpenz për goma te përdorura;dy fatura te Ardi ne vlerë 110€ të Ardi në	ZAP rekomandon qe Menaxhmenti I Komunës duhet të përmbahet kërkesave te pikes 9.3 të Rregullës Financiare dhe Udhëzimet e Thesarit për shpenzimet e Parave Publike Nr 2006/02 dhe ato të aplikohen në praktikë

Auditimi Financiar
Komuna e Deçanit për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2007

	emër të materialit për qepje etj Po ashtu ne kemi vërejtur se është paguar fatura nr 0112507 në vlerë 99€e shitësit Dea-Deçan për blerjen e një qelsi nr 01-02.Çmim I lartë dhe jo I zakonshëm sipas rrethanave në Kosovë	
--	---	--

	Të hyrat	
7	Të hyrat nga Admonistrata arkëtohen nga shërbimet e ofiqarisë për qytetaret e komunës. Nga verifikimi i evidencave vërejtëm se: <ul style="list-style-type: none"> • Nuk bëhet barazimi në mes të departamentit të Administratës me Kontabilitet • Nuk dihet numri i saktë i kërkesave përfituesve të kategorive të liruara nga obligimet. • Arka nuk ka kasafortë ku do të ruheshin paratë si dhe dokumentet e pashfrytëzuara (kuponat)me të cilat është ngarkuar arka 	ZAP rekomandon: <ul style="list-style-type: none"> • Të bëhet barazime ne mes te departamentit të administrates dhe kontabilitetit • Të mbahen evidenca të sakta dhe të ndara për kategoritë e liruara • Të sigurohet një kasafortë për arkën
8	Komuna ne raportet e saj ka raportuar të hyra nga qiraja në vlerë prej 11, 279 euro ndërsa kërkesat e komunës për qira për vitin 2006 kanë qenë në vlerë 24, 133 euro. Prej listës së obliguesve të qirasë zgjodhëm 4 (katër) mostra për ekzaminim. Ne vijim po shpalosim mostrat te të cilat u përfshin në ekzaminim:	Menaxhmentit të Komunës të ndërmarrë këto veprime:të mbajë shënime për të gjitha të hyrat që gjenerojnë transaksione,kopjet e faturave dhe kontratave,të ketë informacione statistikore për numrin e regjistrirove,dokumenteve dhe vlerave të painkasuara.Të bëhen krahasime në mes të hyrave të pritura dhe atyre aktuale dhe të hetohen dallimet e rëndësishme në mesë tyre.Të inkasohen të arkëtueshmet e painkasuara
9	Mostra nr.1 te Qiraja nga Shfrytëzimi i hapësirës publike me Obliguesin e qirasë me numër kontrate 02.NR.308 të datës 13.06.03 ka paguar në emër të qirasë shumën prej 1,260 euro ndërsa obligimi total i tij ka qenë 2,916 euro. Obligimi i qirasë është përbushur në shkallën prej 43 %	ZAP rekomandon që të ndërmerren veprime për mbledhjen e të hyrave të painkasuara. Mos vazhdim i kontratave për bizneset e papërgjegjshëm që nuk paguajnë detyrimet ndaj komunës. Për kërkesat e painkasuara të bëhen shpalosjet në PF të vitit përkatës.
10	Obliguesi i qirasë me numër kontrate 02.NR.308 të datës 13.06.2003 nuk ka paguar në emër të qirasë asgjë edhe pse obligimi i tij për vitin 2006 ka qenë 2,436 euro	ZAP rekomandon që të ndërmerren veprime për mbledhjen e të hyrave të pa inkasuara.Mos vazhdim i kontratave për bizneset e papërgjegjshëm që nuk paguajnë detyrimet ndaj komunës. Për kërkesat e painkasuara të bëhen shpalosjet në PF të vitit përkatës.
11	Obliguesi i qirasë me numër kontrate 02.NR.308 të Datës 13.06.2003 ka paguar në emër të qirasë vetëm 63 euro edhe pse obligimi i tij për vitin 2006 ka qenë 849 euro. Shprehur në përqindje obliguesi ka paguar vetëm 7.62 % të obligimeve të tij.	Të ndërmerren veprime për mbledhjen e të hyrave të pa inkasuara.Mos vazhdim i kontratave për bizneset e papërgjegjshëm që nuk paguajnë detyrimet ndaj komunës. Për kërkesat e painkasuara të bëhen shpalosjet në PF të vitit përkatës
12	Obliguesi i qirasë me numër kontrate 02.NR.308 të datës 13.06.2003 nuk ka paguar në emër të qirasë asgjë për vitin 2006 ndërsa obligimi i tij ka qene 1,638 Euro	Të ndërmerren veprime për mbledhjen e të hyrave të pa inkasuara.Mos vazhdim i kontratave për bizneset e papërgjegjshëm që nuk paguajnë detyrimet ndaj komunës. Për kërkesat e painkasuara të bëhen shpalosjet në PF të vitit përkatës
13	Obliguesi i qirasë me numër kontrate 02.NR.308 të datës 13.06.2003 nuk ka paguar në emër të qirasë asgjë për vitin 2006 ndërsa obligimi i tij ka qene 252 Euro	Të ndërmerren veprime për mbledhjen e të hyrave të pa inkasuara.Mos vazhdim i kontratave për bizneset e papërgjegjshëm që nuk paguajnë detyrimet ndaj komunës. Për kërkesat e painkasuara të bëhen shpalosjet në PF të vitit përkatës
14	Të hyrat nga qiraja nga shfrytëzimi i banesave të banimit social – Janë ekzaminuar tri mostra dhe atë: Obliguesit e qirasë me kontratat e datës 16.04.2005.Nga	Të ndërmerren veprime për mbledhjen e të hyrave të pa inkasuara.Mos vazhdim i kontratave për bizneset e papërgjegjshëm që nuk paguajnë

Auditimi Financiar
Komuna e Deçanit për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2007

	rishikimi vërejtëm se për vitin 2006 kanë pas obligime ndaj komunës në vlerë 310 euro ndërsa për vitin 2006 kanë paguar në emër të qirasë 195 euro.	detyrimet ndaj komunës. Për kërkesat e painkasuara të bëhen shpалosjet në PF të vitit përkatës
15	Të hyrat nga kadastri – Nga evidenca Libri i protokollit të RDPP-së i cili fillon me numrin 001 dhe përfundon me numrin 439 përzgjedhëm pesë mostra. Nga evidenca Libri i protokollit 010/1 (Fletëposeduese / Kopje plani) i cili fillon me numër rendor 1 dhe mbaron me numër rendor 681 morëm tri mostra. Nga evidenca Libri Kërkesa për Teren 010/4 i cili fillon me numër 1 dhe përfundon me numër 90 morëm këto tri mostra. Të gjeturat,ndikimet dhe rekomandimet lidhur me mostrat e rishikuara i paraqesim në vijim:	
16	Në lëndën me numër 010/4-63 kemi vërejtur që Kërkesa nuk ka numër protokoll. Gjithashtu Fleta Poseduese nuk është e nënshkruar nga zyrtarët e autorizuar. Mungon dëshmia e pagesës së tarifës për kërkesë, e kërkuar sipas pikës 1.1 të Vendimit për caktimin e lartësisë së taksave dhe ngarkesave për shërbimet komunale 01.Nr.XXVIII-5 datë 14.09.2005	ZAGJ rekomandon që të respektohen procedurat për iniciimin e kërkesës për shërbimet kadastrale. Fleta poseduese të plotësohet në bazë të kërkesës së formularit të dizajnuara nga menaxhmenti i komunës.
17	Në lëndën me numër 010/4-37 kemi vërejtur që Fleta Poseduese nuk është e nënshkruar nga zyrtarët e autorizuar.	ZAGJ rekomandon të respektohen procedurat për iniciimin e kërkesës për shërbimet kadastrale. Fleta poseduese të plotësohet në bazë të kërkesës së formularit të dizajnuar nga menaxhmenti i komunës.
18	Në lëndën me numër 010/4-63 kemi vërejtur që Kërkesa nuk ka numër protokoll. Gjithashtu Fleta Poseduese nuk është e nënshkruar nga zyrtarët e autorizuar.	ZAGJ rekomandon që të respektohen procedurat për iniciimin e kërkesës për shërbimet kadastrale. Fleta poseduese të plotësohet në bazë të kërkesës së formularit të dizajnuara nga menaxhmenti i komunës.
19	Të hyrat nga shëndetësia – Ky drejtorat grumbullon të hyra nga participimet në shëndetësi. Nga rishikimi i evidencave konstatuam se: <ul style="list-style-type: none"> • Nuk ka barazim në mes të departamentit të hëndetësisë dhe kontabilitetit me dokumentet burimore • Nuk dihet se sa është numri i vizitave të kryera për kategoritë e liruara. 	ZAGJ rekomandon që menaxhmenti i drejtoratit të ndërmarrë këto veprime: <ul style="list-style-type: none"> • Të bëhet barazimi me kontabilitet • Të mbahet evidence e veçante për kategoritë e liruara
20	Të hyrat nga urbanizmi – Gjashtë nga dosjet e auditura nuk e kanë të plotësuar mbështjellësin e lendes. Po ashtu vërejtëm se:	ZAGJ rekomandon që të plotësohet lënda sipas kërkesave të dizajnuara nga dokumenti i komunës “Mbështjellësi i shkresave”.
21	Ne gjashtë nga dosjet e auditura mungon një instruksion I plot,për dokumentet mbështesë që duhet ti bashkëngjiten kërkesës (psh nuk është shkruar që duhet të posedoi edhe vërtetimin për pagesën e tatimit në pronë ,vendimi nga drejtoria e Mbrojtja Civile&Gatishmëri Emergjente.	ZAGJ rekomandon që komuna të nxjerr instruksione të plota për të udhëzuar drejt palët kërkuese në mënyrë që shërbimet e ofruara të jen sa më efikase dhe në kohë .
22	Mungojnë një precizim përveç të lejet e ndërtimit që I bën me dije palës se sa është pagesa. Kërkuesi i shërbimit nuk pajiset me një dokument burimor (faturë) e cila duhet të përfshij edhe shënime tjera plotësuese si shumën e pagesës,arsyen, emrin dhe nr e llogaris etj. Veprimet e tilla nuk përshtaten me kërkesat e dokumentit Procedura mbi të hyrat vetanake për përdorim nga Komunitat e Kosovës të lëshuar nga Zyra e Thesarit në muajin Nëntor 2005.	ZAGJ rekomandon zyrtaret përgjegjës që kërkesat e dokumentit Procedura e të hyrave vetanake për përdorim nga Komunitat e Kosovës të zbatohen në praktikë.

Auditimi Financiar
Komuna e Deçanit për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2007

23	Mungon një dëshmi, e cila do të dëshmonte se palët vërtet e kanë pranuar shërbimin. Ne nuk ishim në gjendje të sigurohemi që palët që parashtrijnë kërkesa kanë marrur një përgjigje, psh datat kur ata vërtet i ka pranuar këto dokumente.	ZAGJ rekomandon që Menaxhmenti I drejtoratit të kujdeset që të udhëheqin evidenca të sakta lidhur me dëshmitë e kryerjes së shërbimeve.
24	Ne tri nga dosjet e audituara mungon pagesa për kërkesat e bëra në zyrën pritëse, që është e caktuar me pikën 1.1 të Vendimit për Caktimin e Lartësisë së Taksave dhe Ngarkesave për Shërbimet Komunale 01.Nr.XXVIII-5 datë 14.09.2005 ku kërkohet që të paguhet 0.50 euro për çdo kërkesë të bërë në zyrën pritëse.	ZAGJ rekomandon që Menaxhmenti i drejtoratit të ndërmarrë veprime që të inkasoji të gjitha të hyrat që kërkohen me rregulloret e zbatueshme.
25	Menaxhmenti i Drejtoriatit gjatë intervistës pohoi se nuk kryhen barazime me Drejtoratin për kontabilitet dhe financa.	ZAGJ rekomandon që Departamenti I financave dhe Departamenti i Urbanizmit të angazhohen për harmonizimin e të dhënave.
26	Të hyrat nga Tatimi në pronë në PF janë prezentuar në shumën prej 147,756.69 prej tyre të alokuara në vlerë prej 146,405.70. Në SIMF janë prezentuar vlera prej 146405.7. Nga raporti i fundit i dërguar në MEF vërehet së vlera e faturuar për vitin 2006 ka qenë 190,557.60 ndërsa vlera e inkasuar ka qenë 109,877.99 që shprehur në përqindje komuna ka inkasuar vetëm 50.75 të faturave të printuara.	ZAGJ rekomandon që Menaxhmenti i drejtoratit të ndërmarrë veprime që të inkasoji të gjitha të hyrat që kërkohen me rregulloret e zbatueshme
	Obligimet	
27	Obligimet e mbetura të komunës së Deçanit sipas pasqyrave financiare nga viti 2006 në vitin 2007 janë 44,598.15 €, prej të cilave; Administrata Komunale 11,179.81 € Shëndetësia 26,888.32 €, Arsimi 6,530.02 € Sipas menaxhmentit të komunës arsye që obligimet kanë qenë në vitin paraprak ka qenë se fatura të vitit 2005 kanë mbetur për tu paguar në vitin 2006 e si pasojë e mungesës së buxhetit që janë paguar këto fatura kanë mbetur obligime në vitin 2007.	ZAGJ rekomandon që komuna mos të hyj në obligime të cilat nuk mund ti paguaj
28	Paga dhe Mëditje - Ne katër nga dosjet e ekzaminuara vërejtëm se mungonin kopjet e identifikimit për të punësuarin ,si dhe dëshmitë për përvojat e me hershme për të punësuarin.	ZAGJ rekomandon Menaxhmentit që të zbatohen kërkesat e pikës 1.2 të Udhëzimit administrativ Nr MSHP/DASHC 20003/11 pika 1.2 Procedurat e Dosjeve të Personelit ku thekson se detajet personale të punësuarit duhet të vendosen në dosjen konfidenciale personale të të punësuarit .
29	Ne pesë nga dosjet e audituara mungojnë dëshmitë për konkursin formën e rekrutimit ,dhe vlerësimin e intervistës së rekrutimit nga komisioni përzgjedhës.	ZAGJ rekomandon që Çdo dosje duhet të përmbaj kopje të shpalljes publike ,përmbledhjen e të gjithë formularëve të aplikimit ,kriterin e e zgjedhjes së ngushtë dhe listën ku mbahen piket e vlerësimit siç kërkohet me UA MShP/DASH 2003/01 Procedurat e Rekrutimit.
30	Listat e pagave nuk janë të nënshkruara për çdo muaj.	ZAGJ rekomandon Menaxhmentin e Komunës që Listat e pagave të nënshkruhen konformë rregullave dhe në afate kohore.
31	Në gjashtë nga dosjet e auditura mungon forma e vlerësimit për periudhën provuese .Periudhën provuese duhet të kalon të gjithë të punësuarit e ri dhe ata që janë ngritur në pozitë në Shërbimin Civil të Kosovës	Menaxhmenti i Komunës duhet të angazhohet që të behet vlerësimi për periudhën në pajtim me kërkesat e Udhëzimit administrativ Nr.MSHP/DASHC 2003/03 Procedurat e Periudhës Provuese (pika 34a.1,2,3,4,)
32	Ne gjashtë nga dosjet e auditura mungon forma e vlerësimit për periudhën e fund vitit, ku çdo I punësuar	ZAGJ rekomandon që Menaxhmenti i Komunës të kujdeset që rregullat e Udhëzimit Administrativ Nr

Auditimi Financiar
Komuna e Deçanit për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2007

	duhet ti nënshtrohet vlerësimit për periudhën një vjeçare dhe një nga kopjet duhet të ruhen në dosjen e konfidenciale të të punësuarit.	MSHP/DASHC2003/8 Procedurat e Vlerësimit të Kryerjes se Punëve të zbatohen në praktikë. Po ashtu kopja e vlerësimit e nënshkruar duhet të përcillet te zyrtari I personelit për arkivim.
33	Ne vitin 2007 në tri nga dosjet e auditura vërehet se ka ngritje ne pagë por nuk ka vendim apo gradim për te mbështet ketë ngritje. Njeri nga punëtoret ka kontratë valide për 2006, sipas listave të Pey rollit ky ka marr vetëm dy paga ne fillim te vitit 2006 .Ka një kopje te pushimit vjetor për vitin 2005, qe e ka shfrytëzuar prej 14.08 deri me 7.09.06. Sipas pohimeve te zyrtarëve te personelit, këtij punëtori ju ka ndërpre kontrata e punës ne ZLK. Mirëpo nuk ka dëshmi për ndërprerjen e kontratës dhe për pagesën e këtij te punësuarit për periudhën tjetër te vitit 20 06(koha kur ai ka shfrytëzuar pushimin e bartur nga viti 2005 është muaji Gusht-Shtator 2006) dhe njëkohësisht ne dosjen e këtij te punësuarit nuk ka formë te rekrutimit për pozitën (zyrtar ne drejtorin për Buxhet dhe Financa) qe mban i punësuarit për vitin 2007.	ZAGJ rekomandon që Komuna duhet te komplettoi dosjet me dëshmi mbështeste ashtu si parashihet me UA për përmbajtjen e dosjeve për te punësuarit. ZAGJ rekomandon që Ndërprerja e marrëdhënies së punës duhet te bëhet në pajtueshmëri me ispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr. MSHP /DASHC 2003/06 Procedurat e Marrëdhënies së Punes.
34	Ne gjashtë nga dosjet e testuar mungon përshkrimi I vendit te punës.	ZAGJ rekomandon që Komuna domosdoshmërisht të siguroji përshkrimin e detyrave te punës dhe e njëjta te mbahet ne departamentin e personelit dhe ne dosjen individuale personale konfidenciale te te punësuarit . ashtu si parashihet me Udhëzimin Administrativ nr. MSHP/DASHC 2003/07 Procedura e Përshkrimit te Detyrave te Punës.
35	Mallra dhe Shërbime - Furnizim me fotokopje për shkolla në vlerë 9,998.00€ Te kjo mostër u vërejtën këto devijime: • Liferimi i mallrave nuk është bërë më kohë.	ZAGJ rekomandon qe Departamenti i Prokurimit të kujdeset që: Të përcillen dhe respektohen kushtet e vëna në kontratë
36	-Furnizim me fotokopje për shkolla në vlerë 9,998.00€ - Furnizim me 200 metra dru për shkolla.- procedurë e përshpejtuar në vlerë 6,600€ - Servisimi I automjetit te ndihmës s e shpejt KIA-shërbime në vlerë 3,690€ Te këto tri mostra në vlerë 13,980€mungojnë dëshmitë mbi pranimin e mallit (fletëdërgesa, fatura apo raporti i pranimit).	ZAGJ rekomandon që: Çdo mall i pranuar apo shërbim I marrë të bëhet në bazë të dëshmimeve të shkruara dhe dokumenteve të dizajnuara me rregulla apo politika të menaxhmentit. Për të gjitha llojet e pasurive (mall fizik)ose për llojet e shërbimeve, zyrtari për logjistik do te siguroi dëshmi te mjaftueshme për mallin apo shërbimin e pranuar.
37	-Furnizim me 200 metra dru për shkolla.- procedurë e përshpejtuar në vlerë 6,600€ Rregullimi i qendrës së qytetit - Faza e dyte në vlerë 44,188.72€. Te këto dy mostra në vlerë 50,788.72€ është vërejt se mungon deklarata e nevojave dhe disponushmeria e fondeve.	ZAGJ rekomandon që çdo aktivitet i prokurimit ose procedurë e veçante prokurimit duhet paraprihet me përgatitjen e deklaratës me shkrim te nevojave dhe te përcaktimit te disponushmëris se mjeteve ne përputhje me nen 8 te LPP. Deklaratë e nevojave dhe disponushmeria e fondeve është dokument i cili duhet te vendoset ne dispozicion nga Organizata Buxhetore.
38	-Furnizim me 200 metra dru për shkolla.- procedurë e përshpejtuar në vlerë 6,600€-Servisimi I automjetit te ndihmës s e shpejt KIA-shërbime në vlerë 3,690€ -Furnizim me fotokopje për shkolla në vlerë 3,690€ Te blerjet kuotuse është vërejtur se mungoin dëshmitë te mjaftueshme te aktiviteti për njoftimin e OE për konkurrim dhe tërheqjen e dosjeve te tenderit.	ZAGJ rekomandon që Departamenti i prokurimit të kujdesët që pjesëmarrësit ne procedurat e kuotimit te çmimeve duhet te përzgjidhen nga operatorët ekonomik te përshtatshëm dhe autoriteti kontraktues do te ftoj qe te marrin pjesë pa qellim diskriminimi kundër ose ne favor te njërit operator ekonomik .Numri i OE qe do të ftohen te koutojnë duhet të jetë i mjaftueshëm për te siguruar konkurrencë efektive ne kontratë dhe nuk duhet te

Auditimi Financiar
Komuna e Deçanit për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2007

		jetë me pak se tre .
39	Furnizimi me 200 metra dru për shkolla.- procedurë e përsheptuar në vlerë 6,600€. Kjo blerje nuk është e parashikuar ne planin e prokurimit. Mungesë e planifikimit prish balancën e planifikimeve te aprovuara për qëllime tjera.	ZAGJ rekomandon që Që shpenzimet e planifikuar me buxhet te shfrytëzohen në mënyrë sa me efikase,çdo shpenzim I menduar duhet te përfshihet në planifikimin e prokurimit Rregullat e Neni 7.1 dhe 7.2 të LPP-së në rastin e planifikimeve të ndryshme të zbatohen në praktikë.
40	-Servisimi I automjetit te ndihmës s e shpejt KIA-shërbime në vlerë 3,690€ Dokumentet për pranimin e ofertave nuk janë te kompletuar .Te regjistri I tenderëve te dorëzuara mungon data e pranimit ora e dorëzimi te ofertave,nënshkrimi I zyrtarit te prokurimit , qe bie ndesh me kërkesat e ligjit te prokurimit Publik.	ZAGJ rekomandon që Departamenti i Prokurimit të kujdesët që informatat mbi numrin, datën, orën dhe identitetin e zyrtarit pranues si dhe të dërguesit të zarfit, për tenderët e pranuar brenda afatit, do të regjistrohen në një “Regjistër të dorëzimit të tenderëve”.
41	-Servisimi I automjetit te ndihmës s e shpejt KIA-shërbime në vlerë 3,690€. Gjatë përpilimit te dokumentit standard për çmimin e ofruar entiteti nuk ka specifikuar siç duhet përshkrimin dhe sasinë e mallrave apo shërbime te kërkuara . Nuk është specifikuar koha kur duhet te kryhet ky shërbim .Autoriteti kontraktues do te përpiloj specifikimet teknike në mënyrë që ato te jen ne përputhje me qëllimet e prokurimit dhe te drejtuar drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë OE e interesuar dhe tenderuesit.	ZAGJ rekomandon që te respektohen rregullat ne përputhshmëri me nenin 28 te LPP për përpilimin e një specifikacionit teknik sa I përket furnizimit me mallra ,shërbime ose punë përkatëse.
	Investimet Kapitale	
42	-Punimi me Kubeza i rrugës Shaban Polluzha në vlerë 79,565€- Rregullimi i qendrës së qytetit - Faza e dyte në vlerë 44,188.72€ Ne te dy këto raste ne dosjen e tenderit nuk kemi hasur dhe nga Autoriteti kontraktues nuk na është ofruar dëshmi mbi depozitimi I sigurimit ekzekutiv te kontratës.	ZAGJ rekomandon që departamenti I prokurimit në asnjë rrethanë mos të bëjë nënshkrimin e kontratës pa siguruar depozitimin e Sigurisë ekzekutive nga fituesi I ofertës ashtu siç edhe kërkojnë rregullat. Të respektohet LPP
43	• Asfaltimi I Rrugës Balaj – Strelc në vlerë 96,997.40€ • Rregullimi i qendrës së qytetit – Faza e dyte në Vlerë 44,188.72€• Asphaltning of road Balaj – Strelc in the amount of 96,997.40€ Të këto dy raste në vlerë 141,186.12€ vërejtëm se mjetet nuk janë zotuar para se të bëhet iniciimi i procedurave te prokurimit.	ZAGJ rekomandon që Zotimi I mjeteve te kryhet para se te fillojnë procedurat e prokurimit.. Kërkesat e Neni 8 të Ligjit të Prokurimit Publik të përcillen në praktikë.
44	Asfaltimi I Rrugës Balaj – Strelc në vlerë 96,997.40€ Sipas ditarit të punës kompania "Lika Trade" ka filluar punën me datë 10.11.2006 ndërsa hapja publike është bërë më date 24.11.2006 . Komuna ka nënshkruar kontratën me OE me datë 1.12.2006.	ZAGJ rekomandon që Menexhmenti i Komunës të hetojë se pse ka ndodhur ky aktivitet. Duhet të përputhet me kërkesat e prokurimit.
45	Edhe pse kontrata është ndërprerë nga menaxherja mbikëqyrës,OE ka pranuar pagesën sipas kontratës për 40% të kryerjes së punimeve poashtu nuk janë aplikuar gjrobat.	ZAGJ rekomandon që Departamenti I prokurimit në asnjë rrethanë mos të bëjë nënshkrimin e kontratës pa siguruar depozitimin e Sigurisë ekzekutive nga fituesi I ofertës ashtu siç edhe kërkojnë rregullat.
46	Rregullimi i qendrës së qytetit - Faza e dyte në vlerë 44,188.72€. OE që është shpallur fitues, ne bazë te dëshmisë nga Administratë Tatimore ka borxhe. I njëjti OE është ende ne procedurën e ankesës ne Bordin e Pavarur për Ankesa.(faza e dyte e rregullimit te qendrës se qytetit ,punët e mbetura pas anulimit të kontratës me fituesin paraprak). LPP neni 61.3 -i OE nuk ka te drejt të marr pjesë në një aktivitet të prokurimit ose në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike	ZAGJ rekomandon që Departamenti i Prokurimit fuqimisht tu përmbahen kërkesave për përshtatëshmërin. Kërkesa që janë të parapara me nenin 61.3.i te LPP-se.

Auditimi Financiar
Komuna e Deçanit për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2007

	nëse OE aktualisht është në vonesë me pagimin e tatimit në Kosovë ose në vendin e themelimit të OE.	
	Shpenzime të vogla	
47	• Në vitin 2006 nuk ka patur kontratë për mirëmbajtje kështu që servisimi i automjeteve është bërë përmes procedurave minimale	• Rekomandojmë që të lidhet Kontratë për mirëmbajtje përmes procedurës së hapur.
48	Ndihmë minoriteteve në rast vdekje - Nuk ka kërkesë si dhe nuk është autorizuar shpenzimi nga Zyrtari autorizues që kërkohet me nenin 20.1 TE LPP-së	ZAGJ rekomandon që të gjitha shpenzimet të autorizohen sipas nenit 20.1 të LPP-së.
49	Subvencion dhe transfere • Nuk gjetëm kërkesa për shpenzimet e bëra. • Në lëndën transporti i futbollistëve për në Rugovë nuk gjetëm vendimin e Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF)	Rekomandojmë që shpenzimeve tu paraprijë kërkesa me shkrim e cila do të miratohej nga Bordi i Drejtorëve apo Komiteti për Politikë dhe Financa varësisht se kompetencë e kujt është.
	Asetet	
50	• Pajisjet përcjellëse të kompjuterëve nuk kanë bar code (numër identifikimi të pasurisë). Ekziston vetëm një bar code i vendosur në njërin prej pajisjeve(njërës pjesë).	• ZAGJ rekomandon që të regjistrohen dhe të pajisen me bar code të gjitha pajisjet.
	Auditor i brendshëm	
51	Komuna e Deçanit ka të angazhuar një auditor të brendshëm. Është angazhuar në muajin Maj të vitit 2006. Nuk ka kryer asnjë trajnim profesional në fushën e auditimit deri në kryerjen e këtij auditimi nga ekipi i ZAGJ(tetor 2007). Auditori nuk është ontabilistë i certifikuar apo auditor të certifikuar.	ZAGJ rekomandon Menaxhmentit të Komunës që të krijojë kushte dhe rrethana për auditorin e brendshëm për përcjelljen e trajnimeve profesionale.
52	Njësitë e Auditimit të Brendshëm nuk ka as Statut të auditimit e as udhëzime të auditimit, që bashkërisht përfshijnë metodologjitë e auditimit, procedurat, përgjegjësitë, mekanizmat raportues, kodin e etikës dhe deklaratën e konfliktit të interesave	ZAGJ rekomandon që të bëhen përmirësime në fushën e raportimit, kualifikimeve të stafit të auditimit dhe mirëmbajtjen e letrave të punës që i plotësojnë standardet ndërkombëtare
53	Është vërejtur se entiteti nuk ka komision të auditimit.	ZAGJ rekomandon menaxhmentit që të formojë Komisionin e auditimit Brenda të komunës konforme kërkesave ligjore dhe praktikave të mira të auditimit
54	Auditori i brendshëm i komunës nuk ka hartuar Plan dhe program për vitin 2006. Sipas pohimeve të auditorit objektivat e auditimit i ka përcaktuar vetë sipas vlerësimeve të tija.	ZAP rekomandon që Auditori I Brendshëm të hartoj Plan dhe program auditimi i cili identifikon të gjitha aktivitetet kyçe relevante të Komunës dhe I njëjti plan të aprovohet nga komisioni I auditimit
55	Ne kemi rishikuar katër Raportin të auditorit të brendshëm dhe kemi vërejt se në raport nuk potencohet numri i mostrave të audituara dhe vlera e mostrave.	ZAGJ rekomandon që përmirësimi i cilësisë së Raportit të auditimit sidomos në konkretizimin e numrit të mostrave të përfshira dhe vlerës se mostrave
56	Auditori I brendshëm nuk ka marrë me shkrim Plan të implementimit të rekomandimeve për auditimet e kryera dhe ai nuk ka mundur të bënë përcjelljen e implementimit të rekomandimeve dhe për të njëjtat të raporton te komisioni I auditimit apo Komitetit për Politikë dhe Financa.	ZAP rekomandon që Menaxhmenti I Komunës të sigurohet që rekomandimet e auditorit të brendshëm të implementohen dhe të merren masa korrektuese..

IV. FUSHVEPRIMI I AUDITIMIT

ZAGJ ka udhëhequr auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Deçanit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2007. Komuna punon nën rregulloren e vetëqeverisjes së Komunave në Kosovë 2000/45, rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/54,2007/30 dhe statutin e Komunës.

Qëllimi kryesor i auditimit është që t'ia mundësojë ZAGJ dhënien e mendimit nëse pasqyrat financiare të Komunës, të paraqitura në Shtojcën I, japin një pasqyrë të vërtetë dhe të drejtë të të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë vitit të përfunduar më 31 Dhjetor 2007, si dhe në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP) mbi “ Raportimin Financiar sipas Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”. Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik i Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK) është përgjegjës për nxjerrjen e SNKSP. Saktësia dhe plotsia e pasqyrave financiare dhe shënimeve përcjellëse në Shtojcën I janë përgjegjësi e menaxhmentit të Komunës.

Auditimi ynë i pasqyrave financiare të Komunës për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2007 është bërë në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare të auditimit (SNA) të nxjerra nga Bordi Ndërkombëtar mbi Standardet e Auditimit dhe Sigurimit. Bordi funksionon si organ për vendosjen e standardeve ndërkombëtare nën rrethanat e FNK. SNK themelojnë kornizën ndërkombëtare Brenda të cilës ZAGJ performon punën e saj dhe mbulon qështjet si parimet dhe përgjegjësitë e përgjithshme, vlersimet e rrezikut dhe përgjigjet në rreziqet e vlersuara, dëshmitë e auditimit, mbështetja në punët e tjerve, dhe concluzionet e auditimit dhe raportimi.

V. MENDIMI I AUDITORIT

Bazat për mohimin e dhënies së mendimit

Përmbledhja e çështjeve të rëndësishme të identifikuara përgjatë procedurave tona të auditimit që na shpjen deri te mohimi i dhënies së mendimit tonë të auditorit janë paraqitur më tej në këtë pjesë. Të gjeturat dhe rekomandimet tona janë shqyrtuar në detaje në Pjesën VII: Të gjeturat kyçe të auditimit dhe rekomandimet.

A. Procesi i kontabilitetit dhe raportimit financiar

1. Pasqyrat financiare të Komunës të paraqitura në Shtojcë të këtij raporti janë të mangëta dhe të jo të harmonizuara me burimet relevante të të dhënave dhe si të tilla nuk janë në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret në fuqi. Prandaj ne nuk ishim në gjendje të arrijmë siguri të arsyeshme mbi përshtatshmërinë e pasqyrave financiare të Komunës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2007.
2. Shumat e të ardhurave të komunës për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2007 siq janë raportuar në pasqyrat financiare nuk janë të barazuara me të dhënat e ndërlidhura të ofruara nga Departamenti i Thesarit në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave. Prandaj, ne nuk ishim në gjendje të arrijmë siguri të arsyeshme mbi plotësinë dhe saktësinë e të ardhurave të komunës për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2007.
3. Në lidhje me tatimet e ndryshme si: tatimi vjetor i pronës, tatimi vjetor për Lejet e Bizneseve, qiraja për shfrytëzimin e pronës së komunës etj. Komuna nuk mban evidencën e duhur dhe të detajaur analitike të debitorëve të saj. Kjo rezulton në mungesë të konsiderueshme të informacionit financiar relevant në lidhje me të ardhurat vetanake. Prandaj, ne nuk ishim në gjendje të sigurojmë vetëveten mbi plotësinë dhe saktësinë e informatave financiare të komunës në lidhje me burimet vetanake.
4. Komuna mban një regjistër ndaras për asetet e saj fikse. Megjithatë, ky regjistër nuk përmban të gjitha informacionet relevante siq është data e blerjes, koha e përdorimit etj. Duke u bazuar në ekzaminimin tonë ne kemi identifikuar ndryshime ndërmjet shumave të pasqyruara në pasqyrat financiare dhe atyre nga regjistri i aseteve fikse në shumën EUR 1,700. Përveq kësaj nuk ka dëshmi të kryerjes së verifikimit fizik të aseteve më 31 Dhjetor 2007 dhe nuk ka harmonizim të librave të komunës. Prandaj, ne nuk ishim në gjendje të kënaqim vetëveten mbi plotësinë dhe saktësinë e të dhënave financiare të komunës për asetet fikse.

B. Dizajni dhe efektiviteti operativ i kontrolleve të brendshme

5. Duke u bazuar në rezultatet e procedurave tona të auditimit në gjetëm të meta në dizajni dhe efektivitetin operativ të kontrolleve të brendshme të komunës

veqanërisht për sa u përket mungesës së proceseve të përshtashme të autorizimit në lidhje me shpenzimet si harxhimi i derivative të automjeteve, riparimet dhe mirëmbajtja, shpenzimet e transfereve të subvencioneve etj. Prandaj ne nuk ishëm në gjendje të arrijmë siguri të arsyeshme mbi vlefshmërinë dhe përshtatshmërinë e shpenzimeve të njohura në pasqyrat financiare të komunës për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2007.

6. Përveq kësaj në lidhje me procedurat e kontrollit të cilat janë vendosur për monitorimin e të ardhurave të inkasuara nga licensat e objekteve me qera ne kemi gjetur se këto kontrole nuk ofrojnë inkasim efektiv dhe në kohë të këtyre të ardhurave.

C. Pajtueshmëria me ligjet dhe rregulloret

7. Çështjet në vazhdim që kanë të bëjnë me mospajtueshmërinë me ligjet dhe rregulloret në fuqi , të cilat janë të shqyrtuara në tërësi në Pjesën VII : Të gjeturat kyqe të auditimit dhe rekomandimet, janë kosideruar të jenë të një rëndësie të veçantë:

- pagesat me para në dore të palejueshme për disa shpenzime,
- procedurat tenderuese për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve jo në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret,
- inkasimi me para në dorë disa të ardhurave
- mos egzistimi i informative relevante të kërkuara nga rregullorja siq janë raportimi i kontratave sipas vlerës së tyre, plani për sigurimin e mallrave dhe shërbimeve dhe dosjet personale të pakompletuara të të punësuarve.

Duke marrë parasysh të mësipërmet, veprime të ndryshme ligjore dhe pretendime mund të pohohen në të ardhmen dhe prandaj ka një risk të gjobave dhe dënimeve shtesë që mund të ngarkohen kundër komunës. Në datën e lëshimit të këtij raporti rezultati i këtyre çështjeve nuk mund të përcaktohet me siguri të mjaftueshme dhe nuk ka pasur shpalosje adekuate për detyrimet kontingjente në pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2007.

Mohimi i mendimit

Për shkak të egzistencës së pasigurive të shumta materiale dhe për shkak të rëndësisë së çështjeve të shqyrtuara në paragrafët paraprakë, ne nuk ishëm në gjendje dhe nuk shprehim mendim mbi pasqyrat financiare të Komunës në pajtueshmëri me SNKSP “Raportimi Financiar nën Bazën e Kontabilitetit të Parasë për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2007.

VI. ÇASJA E AUDITIMIT

Auditimi ynë i pasqyrave financiare të Komunës për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2007, është kryer në pajtim me standardet ndërkombëtare të auditimit (SNA) të lëshuara nga Bordi mbi Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe Sigurisë (BSNAS). Bordi funksionon si një organ përcaktuar i standardeve ndërkombëtare nën patronazhin e FNK. SNA vendosin kornizën punuese ndërkombëtare përbrenda së cilës ZAGJ kryen punën e saj dhe mbulon çështjet siq janë parimet dhe përgjegjësitë e përgjithshme, vlersimi i rreziqeve dhe përgjigjet ndaj rreziqeve të vlersuara, dëshmia e auditimit, mbështetja në punën e të tjerëve, si dhe konkluzionet dhe raportimet e auditimit.

Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësiave tona ne:

- Kemi rishikuar pasqyrat financiare të Komunës në raport me buxhetin e miratuar për vitin 2007;
- Kemi përcaktuar nëse pasqyrat financiare të Komunës janë përgatitur në pajtueshmëri me SNKSP-të “Raportimi financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së gatshme”;
- Kemi kryer testime substanciale gjithëpërfshirëse mbi transaksionet financiare;
- Kemi zbatuar një kombinim të zgjedhjes së mostrave sipas gjykimit dhe rastit, në zgjedhjen e transaksioneve për testim;
- Jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve financiare;

Të gjetura dhe konkluzionet tona të auditimit bazohen në dokumentacionin dhe informatat e tjera të cilat janë dhënë gjatë punës sonë të auditimit. Ka të ngjarë që informata shtesë mund të kenë egzistuar, të cilat nuk na janë ofruar neve, dhe po të na ishin ofruar, mund të kishin ndryshuar të gjeturat.

Për sa i përket mendimit të auditorit të ZAGJ lidhur me pasqyrat financiare të Komunës, SNA definojnë kriteret specifike që përcaktojnë llojin e opinionit që mund të ipet. Mendimi i auditimit mund të jetë i pakualifikuar, i kualifikuar, i kundërt ose mund të jetë edhe mohim i mendimit. Për shembull, ZAGJ mund të mos jetë në gjendje të japë një mendim të pakualifikuar kur egziston cilado nga rrethanat vijuese dhe sipas gjykimit të ZAGJ efekti i çështjeve është ose mund të jetë material për pasqyrat financiare:

(a) Kur ka kufizim të fushëveprimit të punës së auditorit; ose

(b) Kur ka mosmarrëveshje me menaxhmentin lidhur me pranueshmërinë e politikave të zgjedhura kontabël, metodën e aplikimit të tyre ose përshtatshmërinë e shpalosjeve të pasqyrave financiare.

Rrethanat e përshkruara në (a) mund të shpiejnë në mendimin e kualifikuar ose në mohimin e mendimit. Rrethanat e përshkruara nën (b) mund të shpiejnë në mendimin e kualifikuar ose në mendim të kundërt.

Një mendim i kualifikuar në përgjithësi shprehet kur ZAGJ konstaton se nuk mund të ipet një mendim i pakualifikuar, porse efekti i ndonjë mosmarrëveshje me menaxhmentin, ose kufizimi i fushëveprimit nuk është material dhe i përhapur sa të kërkojë dhënien e një mendimi të kundërt ose mohim të mendimit.

